



“RINIA E SHËNDOSHË – RINIA PA DUHAN”

**Fushë Kosovë,
15.06 – 15.07.2009**

Korrik 2009, Prishtinë

*Raport përmbyllës, Projekti: Rinia e shëndoshë – Rinia pa duhan”
Financuar nga : Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve Departamenti i Rinisë
(MKRS/DiR), sektori për edukim shëndetësor financiar nga Fondi Global.*

Raporti e përgatiti: Nehat Bllacaku

Stafi i Projektit :

Udhëheqës i projektit :

Nehat Bllacaku

Kordinatore e aktiviteteve:

Ardiana Osmani

Stafi drejtues i OJQ-së :

Nehat Bllacaku

Drejtor Ekzekutiv

Bardh Ales

Menaxher i Projekteve

Asistente

Teuta Rexhepi

Kryetar i Bordit

Faton Morina

Kontakt :

Prishtinë, Rruga: “Lekë Dukagjini”, Objekti i BL-së nr 3.

Telefon : 044/307 533, 049/307 533, 045/205 214

E-mail : ojqmileniumiiri@yahoo.com ojqmileniumiiri@hotmail.com

Website: www.ngo-newmillennium.yolasite.com

PARATHËNIE

Pasojat e pirjes së duhanit janë të mëdha. Gjendja alarmante është për faktin që shumica e përdoruesve të rregullt janë të moshës së re. Në vendin tonë askush nuk e dinë saktë sa të rinjë fillojnë përdorimin e duhanit çdo vit. Përveç rreziqeve shëndetësore, pirja e duhanit paraqet në mas të madhe edhe dëme mjedisore. Por, a mund të themi që në vendin tonë ka edukatë të mjaftueshme tek fëmijët dhe të rinjtë për rreziqet e duhanit? Mund të themi jo!

Në hulumtimin tonë në kuadër të këtij projekti shumica e të anketuarve, deklaruan se familja edukata kundër duhanit duhet marrë në familje dhe shkollë. Pra, prindërit dhe mësimmshënësist duhet të punojnë më shumë më fëmijët, dhe ti edukojnë ata kundër duhanit. Por, kundër kësaj dukurie negative të gjithë duhet të punojmë më shumë. Ligji kundër duhanit pothuajse nuk zbatohet fare. Ndalimi i reklamimit të duhanit në media, në reklama rrugëve dhe në dyqane, do të kishte efekt pozitiv në këtë drejtim, sidomos tek fëmijët. Kjo për faktin që shumica e të anketuarve u shprehën se reklamimi i duhanit krijon adhurues të rinjë të kësaj dukurie. Se ligji nuk zbatohet dhe se institucionet nuk e kanë marrë asnjëherë për seriozisht ndalimin e duhanit, flete dhe fakti që pothuajse në të gjitha hapësirat e institucioneve publike përdoret duhani. Ose nga të punësuarit ose nga vizitorët. Duhani pihet: në ambientet e komunës, shkollave, ambulancave dhe institucioneve tjera, u shprehën pjesëmarrësit në tryezën e projektit.

Stafi i projekti ka punuar për disa javë rresht në qytetin e Fushë Kosovës dhe fshatrave të saj, në përpjekje për të bërë një vetëdijesim për rreziqet që paraqet pirja e duhanit, sidomos për fëmijët. Në kuadër të projektit janë mbajtur 14 debate me nxënës në shkollat fillore të qytetit dhe fshatrave, është realizuar një anketë me qytetarët e Fushë Kosovës dhe fshatrave, janë mbajtur takime me grupet komunitare, janë shpërndarë fletushka me përmbajtje të rreziqeve të duhanit, janë vendosur poster në pjesë të ndryshme dhe është mbajtur tryeza përmbyllëse e projektit, ku kanë marrë pjesë përfaqësues të shkollave, nxënës, zyrtar komunal dhe qytetar. Në fund janë nxjerrë rekomandimet për drejtorinë e arsimit dhe atë të shëndetësisë, të cilat do të ju paraqiten në formë të shkruar.

Miqësisht

Nehat Bllacaku
Drejtor Ekzekutiv

“RINIA E SHËNDOSH – RINIA PA DUHAN”

Qëllimi i projektit:

Sensibilizimi i të rinjve për rrezikun e pirjes së duhanit dhe organizimi i takimeve me qëllim të zvogëlimit të numrit të përdoruesve të tij.

Objektivat e projektit:

- Zvogëlimi i të rinjve dhe nxënësve duhanpirës :
- Rritja e numrit të rinjve që i shmangen përdorimit të duhanit:
- Intensifikimi i marëdhënjëve nxënës/prindër për këtë problem

Aktivitetet:

Aktivitetet në kuadër të projektit/fushatës kundër duhanit janë mbajtur në pjesën e dytë të muajit Qershor 2009. Aktivitetet fillimisht janë fokusuar në Shkollat Filllore, debatet me nxënës. Një kontribut të madh në këtë drejtim kanë dhënë drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit.

Në të gjitha takimet me nxënës është ligjëruar për rreziqet e pirjes së duhanit. Në debate ka ligjëruar znj. Ardiana Osmani. Debate me nxënës janë mbajtur në shkollat :

- Shkolla Filllore “Mihajl Grameno” Fushë Kosovë
- Shkolla e Mesme Ekonomike, Fushë Kosovë
- Shkolla Filllore “Selman Riza” Fushë Kosovë
- Shkolla Filllore “Selman Riza” Fushë Kosovë, (Paralelja e ndarë)
- Shkolla Filllore “Lismiri” Lismir, Fushë Kosovë
- Shkolla Filllore “Vëllëzërit Frashri” Miradi e Poshtme, Fushë Kosovë
- Shkolla Filllore “Vëllëzërit Frashëri” Miradi e Epërme, Fushë Kosovë
- Shkolla Fillorë, fshati Hencë, Fushë Kosovë
- Shkolla Filllore, fshati Albanë e Madhe
- Shkolla Filllore, fshati Bardh i Vogël
- Shkolla Filllore, Bardh i Madh (2 shkolla)
- Shkolla e Mesme e Elektros, Bardh i Madh, Fushë Kosovë
- Shkolla Filllore, Mes Bardhë (Pomozotin), Fushë Kosovë



TAKIMET ME KOMUNITETET

Në kuadër të projektit janë mbajtur edhe dy takime me grupet komunitare, fëmijët e tyre. Njëri është mbajtur në lagjen 29 në Fushë Kosovë, me fëmijët e komunitetit romë dhe tjetri më fëmijët serb të Bresjes së Fushë Kosovës.

Shpërndarja e materialit vetëdijesues :

Për të arritur një vetëdijesim sa më të madh janë shpërndarë një sërë materialesh. Një pjesë të fletushkave dhe posterëve që i ka ofruar Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHP) dhe një fletushkë që ka përgatitur stafi ynë.

ANKETA ME FËMIJËT DHE FAMILJARËT

Për të krijuar një perceptim sa më real dhe të përafërt të fëmijëve që pinë duhan, nivelit të edukimit dhe problematikave të tjera për këtë dukuri, stafi ynë ka realizuar një anketë me qytetarët. Fillimisht është menduar që të anketohen fëmijët dhe nxënësit. Por për arsye që nxënësit kryesisht në grup nuk e marrin si anketë serioze dhe në anën tjetër fëmijët nuk janë të gatshëm të shprehen në familje për këtë çështje, atëherë janë anketuar familjarët dhe në disa raste me lejen e prindërve edhe fëmijët. Anketa është zhvilluar përmes një pyetësoi prej 10 pyetjeve (2 faqe) :

1. A jeni duhanpirës?
2. A pihet duhani nga të tjerët në shtëpinë tuaj?
3. A qëndrojnë fëmijët tuaj në ambient ku pihet duhani?
4. A dini për rreziqet që shkakton pirja e duhanit, sidomos për fëmijët?
5. A mendoni që fëmijët kanë marrë njohuritë e duhura për rreziqet nga duhani?
6. Sipas jush kush duhet dhënë këto njohuri për fëmijët ?
7. Sipas jush kush ka ndikim në pirjen e duhanit nga fëmijët?
8. Sipas jush a duhet lejuar reklamimi i markave të duhanit ?
9. Sipas jush a mund të ndikojnë familja, shoqëria, mësuesit dhe mediet që fëmijët të mos pinë duhan?
10. A dëshironi të shtoni ndonjë gjë tjetër kundër duhanit tek fëmijët?

Anketa u zhvillua nga znj. Ardiana Osmani në qytetin e Fushë Kosovës dhe në disa prej fshatrave të afërta.

TRYEZA E RRUMBULLAKËT : "DUHANI TEK TË RINJTË-FAMILJA DHE SHOQËRIA"

Tryeza u mbajt më datën 10 korrik 2009, në Qendrën e Kulturës në Fushë Kosovë. Në tryezë ishin ftuar zyrtarë të komunës së Fushë Kosovë, shoqërisë civile, medieve, drejtorë të shkollave, mësime, nxënës dhe qytetar.

Megjithëse shumica e zyrtarëve të ftuar kishin premtuar që patjetër do të vinin, vetëm një pjesë e tyre mori pjesë në tryezë. Në tryezë u paraqiten objektivat e arritura, problemet e hasura dhe përmes projektorit u paraqit anketa me qytetarët në lidhje me përdorimin e duhanit.

Fjalën hyrëse e paraqiti z. Nehat Bllacaku drejtor ekzekutiv i MR-së. Ai foli për projektin, aktivitetet, vështirësitë dhe të arriturat. Më pastaj znj. Ardiana Osmani paraqiti të dhënat e anketës me qytetarët e Fushë Kosovës në lidhje me duhanin. Ndërsa znj. Fatlinda Bajqinca, drejtoreshë e drejtorisë së integritetit në këtë komunë foli për këtë problem. Ajo e paraqiti gjendjen e pirjes së duhanit si tejet alarmante, sidomos të të rinjtë. "Duhani në komunën tonë pihet kudo, shembuj për këtë janë të gjitha institucionet publike, brenda të cilave askush se ndalon pirjen e duhanit". Në tryezë folën edhe prindër të nxënësve, nxënës dhe pjesëmarrës të tjerë. Njëra ndër momentet e debatit ishte edhe rasti ku fëmijët shpalosën përvojën e fituar në debatet e MR-së gjatë këtyre javëve. Në përfundim të takimit u shpërndan fanella (maica) me mbishkrimin e fushatës për nxënësit dhe për kamerierët në disa prej lokaleve ku frekuentojnë të rinjtë, po ashtu janë shpërndarë edhe fletushka kundër duhanit dhe për rreziqet nga përdorimi i tij.

NË PËRFUNDIM TË TRYEZËS DHE TË GJITHA AKTIVITETEVE TJERA, FËMIJËT, MËSIMDHËNËSIT, QYTETARËT TJERË DHE ORGANIZATORËT KANË NXJERRË PËRFUNDIMET:

- Ndalimi i pirjes së duhanit në institucionet publike (komunë, shkolla, drejtori, qendrat e mjekësisë familjare dhe të tjera);
- Rritja e vetëdijesimit të të rinjve nga ana e prindërve, mësime dhe rrethit shoqëror;
- Ndalimi i pirjes së duhanit në hapësirat publike, ndalimi i reklamimit të duhanit në media, në reklama të dukshme në pjesë të ndryshme dhe brenda dyqaneve;
- Themelimi i një njësie të monitorimit dhe parandalimit të duhanit brenda komunës së Fushë Kosovës;
- Nxjerrja e një rregulloreje që ndalon pirjen e duhanit në institucionet publike, reklamimin e tij dhe aspekte të tjera kundër duhanit;



PËRFUNDIM

Ka qenë kënaqësi e madhe për stafin tonë të punojmë me fëmijët dhe të japim sado një kontribut të vogël në krijimin e një opinionit të qartë për rrezikun nga përdorimi i duhanit. Shpresojmë se kemi arritur sado një ndikim të vogël, sidomos te fëmijët të cilëve i është kushtuar ky projekt.

NUMRI I PJESËMARRËSVE

Gjithnjë me përparësi në debatet me fëmijët janë marrë pjesë më shumë se 250 fëmijë, ndërsa në të gjitha aktivitetet afër 500 fëmijë dhe të tjerë. Me këtë konsiderojmë që kemi arritur një sukses në arritjen e qëllimit dhe objektivave të projektit.

FALËNDERIM

Në emër të stafit të OJQ-së dhe bordit drejtues falënderojmë Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Departamentin e Rinisë për përkrahjen e projektit, veçanërisht znj. Mirushe Emini. Po ashtu falënderojmë grupin e fëmijëve dhe prindërit e tyre që lejuan ata të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet tona. Po ashtu falënderojmë Kuvendin Komunal të Fushë Kosovës për mbështetjen dhe besimin e dhënë për realizimin e projektit të në këtë komunë. Ndërsa një falënderim i veçantë shkon për Drejtorët e shkollave ku janë zhvilluar debatet për përkrahjen dhe besimin e dhënë.

FOTOGRAFI NGA AKTIVITETET E PROJEKTIT

